



Zonja, zotërinj, *

Ka kohë që Shqiptarët e Zvicrës janë parë nga disa sikur *ngarkesë* e këtij vendi. Sot Shqiptarët nuk janë *ngarkesa* por *pesha* e këtij vendi.

Me Institutin Zviceran të Studimeve Shqiptare – ISEAL, Shqiptarët nuk janë më vetëm *objekt* i *studimeve* por edhe *studiuës*.

Me ISEAL, ne nuk do të kënaqemi vetëm duke përshkruar dhe informuar por dëshirojmë të veprojmë dhe të prodhojmë në veçanti nëpërmes të *sektorit të hulumtimeve, sektorit të botimeve, sektorit të mësimdhënies* apo nëpërmes të projekteve në mesin e të cilave do të përmendja një botim mbi Shqiptarët e Zvicrës – në gjuhët gjermane, frenge, italiane dhe shqipe – si dhe një Forum Ekonomik.

Këto projekte nuk janë reflekte të lidhura me politika ditore por refleksione që ISEAL i ka kristalizuar me vite të tëra.

Instituti Zviceran i Studimeve Shqiptare e «ka bërë më të vështirën por tani i mbetet të bëjë më të rëndësishëm».

Por 11 anëtarët themelues të ISEAL-it, 12 Anëtarët e Komitetit të Nderit të Shoqatës së miqve të ISEAL-it (aA-ISEAL), 5 anëtarët e komitetit të Shoqatës së miqve të ISEAL dhe më tepër se 130 personalitete, në mesin e të cilëve përgjegjësit e 20 shoqatave të Shqiptarëve në Zvicër, të cilët e kanë themeluar këtë shoqatë, janë garantët më të mirë e nismës dhe e mbarëvajtjes për një kohë më të gjatë të një platforme të komunikimit qytetar unik dhe shembullor në Zvicër.

Kjo platformë është e hapur për të gjitha e për të gjithë të interesuarit.

Për shembull, më 24 prill 2010, në Bernë, gjatë Kuvendit Vjetor të Shoqatës së Miqve të ISEAL-it, pas pjesës zyrtare, ne ishim dëshmitarë të katër nismave që vinin nga anëtarët e saj në mesin e të cilave po e përmendi idenë e krijimit të «Shoqatës së autorëve shqiptarë në Zvicër» si dhe idenë e krijimit të «Shoqatës së arkitektëve dhe inxhinierëve shqiptarë në Zvicër». Bartësit e këtyre projekteve do të kenë mbështetjen tonë.

Sa më i thellë të jetë lumi, më i qetë është, thotë një fjalë e urtë shqiptare. Sa më shumë që njohuritë tona të ndërsjella të thellohen, shpirtrat tanë qetësohen. Kështu miqësia jonë bëhet vëllazëri, se *një mik është një vëlla pa hise*.

Ne jemi të përcaktuar dhe të motivuar që të përmbushim synimet dhe qëllimet tona sepse *nga dashuria që kemi për vendet tona të origjinës, ne e adhurojmë Zvicrën*.

Ju falënderoj që na e dhatë kënaqësinë që ne të ndajmë bashkërisht nisjen e ISEAL-it që nuk është tani vetëm nismë e jona por edhe e juaja. Sepse, *për të shkuar shpejt, në ecëm vetëm, por për të shkuar më larg, ne dëshirojmë të ecim bashkë me ju*.

Driton M. Kajtazi

* *Fjalim me rastin e Ceremonisë së hapjes së ISEAL-it / Qendra shumëkulturore në Ouchy – Lozanë / E premte 12 nëntor 2010*